



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KRYETARI

Nr. 1185 prot

Gramsh, me 26/03/2021

**VENDIM**  
Nr. 50, datë 26/03/2021

**PËR**  
**CAKTIMIN E VENDEVE PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE**  
**PROPAGANDISTIKE ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 dhe nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore"; nenit 79 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); Udhëzimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr.6, datë 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", me qëllim përcaktimin e rregullave për afishimin e materialeve propagandistike gjatë periudhës zgjedhore;

**VENDOSA:**

1. Materialet propagandistike të cilat do të përdoren nga subjektet lejohen të afishohen në një distance deri në 5 (pesë)metra larg zyrës zgjedhore të partisë apo subjektit zgjedhor përkatës. Me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore të marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.).
3. Të merren masa për të mos lejuar dhe për të hequr menjëherë çdo material statik, përfshirë posterat dhe flamujt nga çdo vendndodhje tjetër ku ato konstatohen që nuk janë vendosur në përputhje me kriteret e këtij vendimi.
4. Ndalohet vendosja e materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik
5. Caktimin e sheshit "Kamber Dërmyshi" si vend për afishimin e materialeve edukuese zgjedhore dhe informuese në dispozicion të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar.

6. Zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhorë mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-së, QV-ve dhe VNV-së. Të bëhet verifikimi i vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të Udhëzimit Nr.6, date 23.03.2021 për afishimin e materialeve propagandistike.
7. Subjektet zgjedhore të njoftojnë me shkrim Kryetarin e Bashkisë dhe të bëjnë me dije KQZ-në për hapjen e zyrave zgjedhore dhe për adresat e sakta të tyre.
8. Administrata e bashkisë, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit, të bëjë verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të udhëzimit për afishimin e materialeve propagandistike
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Sektori i Shërbimeve Publike dhe Komunalet në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, Koordinatorin për të drejtën e informimit për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të bashkisë, si dhe një kopje t'i dërgohet Komisionerit shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionariatit të Policisë Gramsh.
10. Vendimi Nr.41, datë 02.03.2021 i Kryetarit të Bashkisë "Për caktimin e vendeve për afishimin e materialeve propagandistike", **shfuqizohet**.
11. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
KLODIAN TACE**

